



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 15-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 31. 01. 2019, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Lulzim Rrustemi, anëtar
12. Ramiz Qeriqi, anëtar
13. Argjent Tasholli, anëtar
14. Nazmi Krasniqi, anëtar
15. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Selatin Retkoceri, anëtar
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Rasim Hasani, drejtor i DA

6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
10. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
11. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
13. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
14. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
15. Kimete Jashanica, OSBE-së
16. Bukuriye Zejnullahu, zyra e informimit
17. Besart Troshupa, zyra e informimit
18. Përfaqësues të mediave dhe numër i konsiderueshëm i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Rrahim Krasniqi**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 29 anëtarë nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 14-të e Kuvendit.
2. Informatë për punën e KKS-së në Lipjan për vitin 2018.
3. Propozim rregullorë për taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.
4. Propozim rregullorë për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve sportive publike dhe fushave të hapura sportive.
5. Propozim rregullorë për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus.
6. Propozim vendim për miratimin e Planit për ri-organizimin e pikave të mbeturinave në qytetin e Lipjanit.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Meqë nuk pati vërejtje as plotësime me të gjitha votat prezente kaloi rendi i ditës.

Pastaj Kryesuesi, Daut Azemi, tha se vazhdojmë me pyetjet parlamentare?

Shkelzen Bislimi, kam një pyetje për drejtorin e arsimit, a zbatohet kontrata kolektive nga Komuna e Lipjanit sidomos neni 85 pika 8 dhe 9 për pagën jubilarë, tri pagesat e arsimtarëve që dalin në pension. Po ashtu kam një pyetje për drejtorin e inspektoratit. A po zbatohet Ligji që ndalon shitjen e alkoolit dhe duhanit për fëmijët nën moshën 18 vjeçare, pasi që shpeshherë po shohim fëmijë duke përdorur alkoolin dhe duhanin.

Selatin Retkoceri, nuk kam parë që këto ditë drejtori apo Kryetari i Komunës është marrë me një temë kaq të ndijshme të arsimit. Sot është dita e 14 e grevës një çështje shumë e ndijshme dhe ne po sillemi sikur nuk ka ndodhur asgjë. Para lufte ka qenë kogja problem me e humbur mësimin. Ne sot po e humbim 3 javë dhe fare nuk merremi me këtë çështje. Ne jemi për ngritjen e pagave dhe për rritje të dinjitetit. Por dinjiteti matet me punë. Unë nuk kam fëmijë në shkollë por fëmija e neve të varfërve janë nëpër shkolla publike.

Ne nuk do të duhej të dalim nga kjo sallë pa filluar mësimi pasi që nuk ka kush t'i riparoj këto humbje.

Imri Ahmeti, dakordohem për atë që tha z. Retkoceri por jo për të gjitha është një situatë jo e mirë. Askush nuk e ndien veten mirë për humbjen e orëve të tëra bazuar në përgjegjësitë tona kemi marrë një pjesë të organizimeve javën e parë kemi mbajtur një takim me SBASHK-un,

drejtori i drejtoratit ka vizituar të gjitha shkollat. Prap kemi mbajtur një takim para 3 dite. As një masë ndëshkuese nuk mund ta marr ekzekutivi i komunës as drejtorati i arsimit edhe në sektor tjerë nuk është situata mirë, vetë i kemi pri të keqës nga niveli qëndror kur po vijnë zgjedhjet po bëjnë marrëveshje me ZBASHK-un për votë dhe unë nuk gjejë mundësi reale me i akuzua punëtorët e arsimit. Sepse edhe ata janë prind dhe i kanë fëmijët e vet në shkollë. Dhe kur bëjnë grevë për fëmijët e tyre bëjnë për të gjithë. Dikush pyeti për pagat jubilarë se dikush nga niveli qëndror e nënshkruan kontratë kolektive për qëllime populiste, e në anën tjetër nuk ua qet mjetet financiare komunave për ato paga. E krejt këto po bëhen për poena politik. Dhe unë po them asnjë komunë nuk mund të marrë masa ndëshkuese ndaj punëtorëve të arsimit. Në fund bëne një deklaratë ju anëtarët e Kuvendit që të bëhet një zgjidhje për fillimin e mësimin nga ana e Sindikatës dhe Qeverisë.

Nehat Tërpeza, pajtohem me dy parafolësit, njëherit përgëzoj ekzekutivin për tejkalimin e planit të të hyrave vetanake që janë diku mbi 21%. Para disa muajve kemi bërë një kërkesë për ndryshimin e Statutit të Komunës dhe t'i bëjë një kërkesë Qeverisë për fshatin Suhadoll që t'i kthehet komunës së Lipjanit. A është bërë ndonjë kërkesë lidhur me këtë çështje dhe deri ku kanë shkuar procedurat. Çështja e dytë ka të bëjë me rishikimin e vendimeve dhe Rregulloreve që janë marrë në vitin e kaluar siqë është rasti ndarjes së lokacionit për Xhamin e Lipjanit. Po ashtu edhe Rregulloren e shërbimeve të varrimit deshta me ditë deri ku ka shku kjo çështje dhe a është bërë ndonjë kërkesë për shpenzimet e varrimit nga ana e qytetarëve dhe a mendoni se a janë dhënë informacione të duhura për shpenzimet e varrimit. Po ashtu kërkoj që të mirren parasysh zgjedhja e këshillave të fshatrave si dhe të vijë në Kuvend Rregullorja dhe të bëhen plotësime ndryshimet e nevojshme. E kam një vërejtje për drejtorin e inspektionit ku disa prej marketeve të mëdha po i shpërndajnë disa fletushka nëpër fshatra duke angazhuar disa djem të ri ku po i vendosin nëpër vende jo të duhura këto fletushka dhe po e dëmtojnë ambientin.

Ganimete Qeriqi, pasi vijë nga fusha e shëndetësisë edhe unë si kolegët nga arsimit dua të flas diçka për fushën të cilës i takoj. Kam një çështje ku drejtori i QKMF-së ka bërë shkelje jo vetëm këtë herë por vazhdimisht ka shkelur të drejtat e personelit. Ku urgjenca e QKMF-së vazhdimisht i nënshtrohet presionit të këtij drejtori ku asnjëherë nuk ka qenë brengë çështja e pacientit por vetëm ruajtja e pozitës së drejtorit. Ky drejtor ka shkelë të gjitha ligjet ku e ka stresu pacientin dhe e ka vu në lajthitje edhe Kryetarin e komunës. Ajo çka ka ndodhur në QKMF në Lipjan është e ulët jo etike. Unë e ftoj Kuvendin, shoqërinë civile, zyrën për barazi gjinore që ta hulumtoj rastin. Emergjencia është ajo që merret me raste më të rënda, ndërsa kur është puna te privilegjet i merrë drejtori për veten dhe motrën e tij. Kolegët e mi qëndrojnë prapa meje për çështjet që i ngrija, ku punëtorët kërkojnë shkarkimin e këtij drejtori.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket çështjes së emergjencës Ganja ka qenë aty dhe unë nuk kam shku menjëherë por më është dashtur të shkoj dhe unë do të jem në anën e pacientit kushdo që të jetë ai, por nëse ka dikush tendenca për me i nda pacientat politikisht unë prap do të jemë aty. Ju nuk mund të silleni si të doni aty, nuk mund t'i thoni pacientit shko të kontrollojnë ai doktor ose doktori tjetër pavarësisht a është familjari im apo i dikujt tjetër. Në emergjencë ka qenë vetëm një mjek por për shkak të numrit të shtuar tash janë dy mjek dhe ata janë para vitit të ri. Dhe unë nuk do të lejoj që aty të luhet zhol dhe të ketë kauza të fjetjes. Gane unë atë ditë të pyeta ke qenë bashkë me mu se çka janë këto 5 zyre dhe nuk është në rregull që gabimet e juaja me ja gjujtur dikujt tjetër. Në shëndetësi ka ndodh reforma ku ka evidencë të hyrje daljeve dhe ka restaorim të brendshëm. Ndërsa nëse kini personale me drejtorin udhëro ngritni procedurat ndaj tij nëse nuk është sillë mirë. Unë do të jem në anën e pacientit kush do çoftë ai. Ka këtu delegate që janë shku zyrë zyrë dhe ju kanë thenë hajde hyna në grevë. Kush do të jep përgjegjësi nëse nesër ai pacient vdes dhe të nesërmen ai pacient është kthyer në spital, dhe ende është në spital ai pacient.

Ganimete Qeriqi, e di që Kryetar që sjellja jote ka qenë shumë e mirë atë ditë por pse na femrat me ra viktim për shkak të dikujt tjetër. Ku i njëjti drejtor me ekip të patronazhit kanë shku me e sheru pacientin në shtëpi e që nuk ka pasur nevojë. Pacientit dhe familjes Ahmeti i kërkoj falje pasi që e ka gjendjen shumë të vështirë. Kur të kam pyet Gane ke thane se kjo dhomë

është për doktor, kjo për doktoresha, kjo për infirmer, kjo për informere, kjo për vozitës. A nuk bërë motrat me doktoresha me pasur një dhomë të përbashkët a? Sa i përket asaj që po e thu ti Gane gjinia femnore qoftë motrat qoftë doktoreshat e kanë një dhomë dhe doktorët dhe infermërt një dhomë tjetër dhe ato dhoma ju shërbejnë për ndërrimin e uniformave të juaja dhe banu fer Gane kur jamë ardhur unë ju nuk keni pasur as uniforma.

Albulena Kelmendi, që 14 ditë jemi në grevë për shkak të pa drejtësisë që na është bërë me koeficientin e Ligjit të pagave, e shfrytëzoj rastin të ju kërkoj falje atyre familjarëve për nxënësit që i kanë nëpër shtëpia për shkak të grevës sonë. Arsyet pse po bëhet greva janë të çarta dhe nuk kam çka të shtoj më shumë. Po du me falenderu ekzekutivin që asnjë herë nuk kanë bërë presion e kjo është shumë e mire e jo deklarata qesharake siqë janë të Agim Bahtirit. Është gjetur momenti i duhur ku po i bëhet diskriminim çesharak me këtë koeficient punëtorëve të arsimit, e me paga marramendëse që i kanë dikush për krovata e këmisha. Greva është e drejtë ligjore dhe nuk mund të bëjmë më shumë në këtë drejtim e shpresoj që kërkesat tona të realizohen. Kam një pyetje lidhje me barnatorët në komunën e Lipjanit ku dallojnë çmimet dukshëm njëra prej tjetrës. Drejtori i inspektionit duhet të ndërmarr diçka lidhur me këtë çështje. Çështja tjetër është shqetësim i disa prindërve lidhur me çështjen e kurseve që po i mbajnë disa prej profesorëve të shkollës “Vëllëzërit Frashëri” me nxënësit që iu jepin mësim. E në shkollë i anashkalojnë nxënësit të cilët nuk kanë para të shkojnë në kurs e dorën në zemër sot pak nxënës kanë kushte të shkojnë në kurse private e po kërkoj që të ndërmirret diçka ndaj këtyre arsimtarëve. Kam edhe një pyetje për drejtorin e arsimit pse në shkollë nuk është lejuar të ju ipen çertifikatat për trajnimin e kryer nga SBASHK-u punëtorëve të arsimit në shkollën “Ismajl Luma” ju ka ndaluar hyrja dhe janë detyruar që këto çertifikata t’i shpërndajnë në oborrin e shkollës.

Argjend Tasholli, kërkesat e mia zakonisht po bijnë në vesh të shurdhër të ekzekutivit. Duhet të dilet në teren dhe të shiqohet mbyllja e disa kanaleve nga ujërat e shiut mos pritni të dëmtohen qytetarët. Kemi raste në fshatin Gadime, Qallapek, Gllavicë, Sillovi dhe disa fshatra tjera dhe kemi rastin e Sitnicës që e keni përdorur gjatë fushatës që do ta mirëmbani dhe do ta hapni sa here që është nevoja. Tokat që janë për rreth asnjë nuk mund të përdoret për të mbjellura. Problemin tjetër e kemi me kanalizim ka plotë fshatra me probleme të tilla. Një qytetarë nga Dobroja më ka shkruar nuk kemi kanalizim. Problemin e njëjtë e kemi edhe në Krojmir dhe Gllavicë. Një qytetarë nga fshati Krojmir thotë se një pjesë e fshatit ka kanalizim e një pjesë jo kurse pjesa tjetër që e ka kanalizimin kanë probleme. Krojmiri ka nevojë për ambulancë, trotuare, për ndriçim etj. Problemin tjetër e kemi me kodrën e krimit dhe korrupsionit në zemrën e Gadimes. Kur e them fjalën krim dhe korrupsion flas për gjitha pushtete që kanë shkatërruar bukurin e një vendi turistik siqë është Gadimja. Një kompania e caktuar që nuk e njoh dhe nuk dua ta njoh kanë filluar të gërmojnë nga varrezat e fshatit pjesën tjetër kanë filluar të gërmojnë ku rinia e fshatit e shfrytëzojnë për aktivitete dimërore dhe verore. Ju lutem t’i ndaloni këto aktivitete të kundërligjshme.

Lumturije Bytyqi-Hasani, sa i përket emërgjencës ata shtretër janë që një kohë të gjatë aty që nga pas lufta. Edhe unë jam për t’i mbrojtë të drejtat e pacientit qoft i afërmi i juvi apo i imi, por jam për t’i mbrojtur edhe të drejtat e punëtorëve. Qeverisja aktuale i shkel të drejtat e punëtorëve duke mos i paguar pagat shtesë. Po ashtu nuk paguhen për punë gjatë vikendeve. Unë ju ftoj që të analizohet edhe një herë çështja rreth emërgjencës. Kur e dijmë se punëtorët e emërgjencës aty punojnë 12 orë në karrige të plastikës dhe atyre duhet të ju ofrohen karrigë më të përshtatshme pasi që ju bjen të punojnë më gjatë.

Vlora Limni-Hajnuni, iden e ndryshimit dhe reformës që t’i e din Lume që ka fillu 2018. Në dhomën e recepcionit t’i e din se aty ka pasur shtretër dhe aty është bërë renovim. Sa i përket pacientit nuk ka kërku trajtim special por problemi ka qenë në mes stafit. Pacienti është në gjendje shumë të vështirë. Në shërbimin e emërgjencës është kërkesë të jenë dy doktor për ndërrimin e natës për shkak të numrit të madh të pacientëve dhe këtë e kemi plotësuar. Kontratat kolektive nënshkruhet prej ministrit dhe ministri fare nuk konsultohet me ministrin e

financave. Nga 2018 në 2019 kemi rritje të pagave për shërbyesit shëndetësorë, dhe nuk është e vërtetë që nuk paguhen ndrrimet e natës dhe festat.

Lulzim Rrustemi, përshëndetje për të gjithë uroj që situata e grevës të përfundoj se është mire edhe për mësimdhënësit edhe për nxënësit që të rregullohet kjo punë sa më shpejt.

Por unë po e ngris një shqetësim për pranimin e një arsimitare të gjuhës angleze në fshatin Rufc. Në shkollën fillore "Migjeni" që është bërë një shkollë ligjore është pranuar një arsimitare që nuk i plotëson kushtet e konkursit, ndërsa keni refuzu një arsimitare që i ka plotësuar kushtet e konkursit. Dhe ju nuk keni pranuar me i shqyrtu ankesat.

Sa i përket fjalës së Kryetarit se ka pa përgjegjësi totale në emërgjencë ju jini në pushtet që 5 vite dhe është dashtë me marrë masa dhe mos me ardhë deri te skandalet të cilat kanë ndodhë. Nëse aty ka mos punë atëherë përgjegjësia është e juaja. Uroj që gjithçka në emërgjencë të përmirësohet.

Ramiz Qeriqi, kam një shqetësim të subvencionet për OJQ-të për vitin 2018 që janë dhënë pa i plotësuar kriteret deri në 2 mijë euro dhe pa konkurs. Te rruga 4 korsi është mirë me ndërhy me marrë masa për ndërtesat që janë ndërtuar në pronën publike. Kisha dashtë me ditë në seancën tjetër cila ndërtesë është në pronën publike sidomos aty te Dino e din të gjithë se rrethi ka mbetur i vogël. E kam një kërkesë të shenjat e rrugës të hekurudha nuk ka shenja, është një gjysmë shenje. Te furra "Drin i Bardh" është një kontinjer që po pengon dhe shkaku i kontinjerve ka pasur një aksident është mirë që ata kontinjera me i largu jashtë rrugës. Sa i përket shëndetësisë deshta me dhënë kontributin tim por kisha kërkuar nga drejtoresha që të më ndihmon pasi që këtu do të jem pa parti ku një shofer thotë se më ka thenë gjithçka Kryetari, Ganja mua më ka qu te qeshmja dhe thotë se këtu nuk ka kushte për punë. Është mirë me na ndihmu drejtoreshë me i marrë kamerat e sigurisë dhe me dalë të gjithë përgjegjësit para gjyqit. I keni kamerat dhe mundeni me ndihmu në këtë drejtim. Unë kam shku aty në cilësinë e asambleistit, në cilësinë e qytetarit dhe ju kisha lut drejtoreshë që të më ndihmoni në këtë rast.

Nazmi Krasniqi, unë i kam dy pyetje kur do të bëhet zgjedhja e kryetarëve nëpër fshatra dhe e dyta kur do të bëhet emërtimi i rrugëve nëpër fshatra.

Argjend Krasniqi, deshta edhe unë me u ndërlidh të shëndetësia sa i përket aktivitetit që e kam bërë unë nuk ka qenë politikë edhe pse ju pe quni politikë. Nëse unë e bëjë një postim nuk e bëjë pa fakte dhe nëse mendoni që unë kam bërë shpifje atëherë janë gjykatat.

Imri Ahmeti, këshillat komunal që u përmendën nga dy këshillëtarë shumë me vend. Mbledhje në sallën e Kuvendit mbajnë të gjitha partitë jasht orarit të punës vetëm që bëjnë kërkesë, ndërsa çështja e broshurave është diçka tjetër.

Selatin Retkoceri, unë prita nga punëtorët që punojnë në arsim pak më shumë me folë rreth kësaj teme. Është mirë ne sot me dalë me një komunikatë t'i thërrasim arsimtarët së paku me fillu mësimi.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, unë e kam një propozim nëse Kuvendi pajtohet që Selatini, një anëtarë nga LDK-ja, një nga PDK-ja ta bëjnë një deklaratë jo politike pasi që është propozues ta bëjnë një deklaratë në emër të Kuvendit.

Nazmi Krasniqi, nuk është mirë me bër një deklaratë të tillë pasi që është çështja e nivelit qëndror dhe më duket se është një deklaratë qesharake.

Lulzim Rrustemi, Kryesues duhet me bërë përpjekje me zbatu Rregulloren e Kuvendit, për të gjithë njëjtë, por edhe Kryetari nuk ka të drejtë me e fy asnjërin nga anëtarët e Kuvendit pavarësisht a i pëlqen apo jo. Edhe ti si Kryesues ki të drejtë me ju marrë fjalën anëtarëve të Kuvendit dhe Kryetarit.

Imri Ahmeti, Kryetar i Kuvendit, tha se le të tërhiqet anëtar i juaj i Kuvendit për fjalën fyese e thenë publikisht dhe kushdo që respekton e respekton vetëveten, kushdo që fyen e fyen vetëveten dhe kushdo që më kursen do ta kursej.

Megjë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 14-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Megjë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 14-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 votat për, një apstenim

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 14-të e Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Informatë për punën e KKSB-së në Lipjan për vitin 2018

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Nazim Gashit, drejtor i DMSH, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, deshta ta bëjë një pyetje në lidhje me sigurin në shkolla dhe rastin e narkotikëve nëpër shkolla a ka ndonjë strategji nga komuna jonë.

Albulena Kelmendi, ne edhe në KPF, e kemi diskutu për këto tri rreziqe që po u kanosen qytetarëve të komunës së Lipjanit siqë janë: ndotja e lumenjëve, qenët endacak dhe problemi me narkotik. Unë kam kërku nga drejtori i DMSH-së Nazim Gashi a ka ndonjë strategji për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe qysh kishim mund ne si asambleist të komunës me ndihmu.

Për qenët endacak tash më e kemi një Rregullore mirëpo dukuria e tretë e narkotikëve është shqetësuese nëpër shkollat e mesme duhet të gjithë me ndërmarrë diçka në këtë drejtim. Në një takim që ka qenë edhe policia kam kërku për kontrolla sistematike nëpër shkolla.

Selatin Retkoceri, kërkoj nga inspektorët së paku të ndërmarrin diçka për ndalimin e duhanit i cili po përdoret në të gjitha lokalet.

Lulzim Rustemi, sa i përket informatës ka kogja shumë gabime gjuhësore dhe drejtëshkrimore, ndërsa sa i përket asaj se nuk kemi mbështetje financiare ju duhet më heret me i parashtrur kërkesat qoftë në Kuvend apo në KPF. Këtu nuk janë ngritë shumë çështje që kanë të bëjnë me siguri në komunën e Lipjanit.

Hyra Bytyçi, së pari falenderoj drejtorin për informatën e KKSB-se është një raport transparent ku tregon për të arriturat dhe ngecjet e këshillit po ashtu flet për qenët endacak, vërshimet dhe narkotikët. Ne si grup parlamentarë i LDK-së dhe PD-së e mbështesim dhe do të jemi gjithmonë pran tyre.

Nazim Gashi, Këshilli Komunal në Bashkësi është një trup këshillues dhe nuk ka fuqi ekzekutive. Anëtarët e KKSB-së janë ata që sjellin informata nga dora e parë dhe këto probleme ne i adresojmë tek organet përkatëse të sigursë.

Megjë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike u kalua në punë sipas pikës së tretë të rendit të ditës.

III

Propozim rregullore për taksën administrative për leje ndërtimore, leje rrënimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiqi, drejtoreshë e DPU, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ukë Kryeziu, kam një pyetje për drejtoreshën rreth ndryshimit në nenin 9 ku nuk na tregoj për lirim nga taksa pa hy në detaje të donacionet familjet të ngushta të dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranëve, të burgosurve etj. Por ka dal me një dokument të ri ndërtim për banim individual për përfitues të skemave sociale.

Lulzim Ristemi, mua më intereson për ndryshimet, tarifa për kategorin e parë 1.80€, taksa administrativ për kategorin e dytë 2.50€ dhe taksa administrative për rrënimin 0.64€ a janë bër ndryshime dhe cilat janë kushtet që kanë derivu për me pasur ngritje të çmimeve? Cilat janë arsyet që kanë ndiku në rritjen e taksës këtë vit në krahasim me vitin e kaluar kisha dashtë sçarim. Po ashtu kisha dashtë një sqarim për taksën për nenin paraprak është thënë që shtepit që ndërtohen përmes donacioneve për kategoritë e dalura nga lufta, për ndërtim lirohen nga taksat. Një sqarim për çka është pyetja?

Selatin Retkoceri, te neni 9 neni pastaj vjen neni 7, tani vjen 8, te procedurat e ankesave dashta një sqarim.

Hyra Bytyçi, sa i përket kësaj Rregullore për taksën administrative për ndërtim, rrënim e përkrahim ne si grup parlamentar në të ardhmen kjo taksë duhet të rritet pasi që jemi ndër komunitet me taksën më të ulët për ndërtim dhe rrënim.

Emina Rexhiq, edhe atë ditë në KPF e kam cek se janë disa gabime teknike. Ndërsa lirimi bëhet në bazë të udhëzimeve administrative. Ndërsa rritja e taksës bëhet sipas buxhetit.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 votat për, aprovoi këtë:

Shtesë: Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi dha pauzë prej orës 12⁰⁰ deri në ora 13³⁰

IV

Propozim rregullore për mënyrën dhe kushtet e menaxhimit dhe shfrytëzimit të objekteve sportive publike dhe fushave të hapura sportive.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Bakim Shabani, drejtor i DKRS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Albulena Kelmendi, kisha dashtë me ja bër një propozim drejtorit për kategoritë e dalura nga lufta të lirohen nga pagesa për përdorimin e këtyre objekteve.

Shkelzen Bislimi, një punë e bërë mirë sa i përket kësaj Rregullore shpresoj të jetë edhe në praktikë. Ne e përkrahim këtë Rregullore vetëm deshta me ditë se a kanë pranim teknik këto fusha, e nëse kanë shumë keq pasi që ka fillu me u dëmtu ajo fushë.

Afrim Miftari, ne edhe në KPF kemi pyet drejtorin që përveç objekteve sportive të përfshihen edhe objektet kulturore po ai dha sqarimin dhe kemi kërku që Kuvendi sa ma shpejt ta sjellë në Kuvend një Rregullore nëse nuk ekziston për mënyrën e menaxhimit të objekteve kulturore në komunën e Lipjanit me shpresë që neni 16 ku parashihen masat ndëshkuese të vije sa më pak në konsideratë. Ajo Rregullore është e mirë se ardhur për të gjitha subjektet të cilat dëshirojnë t'i shfrytëzojnë ato objekte.

Anila Reçica, ne si grup e përkrahim këtë Rregullore dhe e inkurajojmë drejtorin që të na sjellë Rregullore të tilla

Lulzim Rrustemi, kam dy pyetje dhe atë: ambientet sportive a kanë staf të mjaftueshëm dhe a ka investime të banjot të cilat kanë qenë në gjendje jo të mirë. Përndryshe edhe ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Rregullore.

Bekim Shabani, kategorit e dalura nga lufta dhe me nevoja ndryshe do të përcaktohet me Rregulloren tjetër. Sa i përket stafit nuk ka staf të mjaftueshëm por e kemi parapa që me atë staf ta mbulojmë punën.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 29 votat për, aprovoi këtë:

Shtes:Rregullorja.

V

Propozim rregullore për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Ilir Tasholli, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, ne e përkrahim këtë Rregullore duhet me u mundu me zbatu edhe në praktikë. Kam pyetje a ka mundësi të vendosen tabelat për orarin e linjave të autobusëve ku janë të caktuara vendet ku do të ndalen autobuset sipas kësaj Rregullore.

Albulena Kelmendi, ne e përkrahim këtë Rregullore por deshta të shtoj një brengë të qytetarëve të fshatit Teqe të cilët ankohen për numër të vogël të autobusëve dhe kërkesa është që me i shpeshtu linjat e autobusëve për këtë regjion. Kërkesa e dytë është një linjë të cilët e kërkojnë ata pasi që biletat të cilat i paguajë tani kanë shumë të madhe ku shkon deri në 35€ ku shumica prej tyre janë student ose nëna të cilat shkojnë të pastrojnë. Këta qytetarë kërkojnë që të kthehet kompania 24 Yjet e cila ka qenë më e lirë dhe ju ka lehtësu hyrjen direkt në qytet. Kërkoj nga drejtoria përkatëse të marrin parasysht këtë kërkesë të këtyre qytetarëve.

Ramiz Qeriqi, kam një kërkesë që linja e fundit e autobusëve për Prishtinë të jetë deri von në ora 22 pasi që deri në ora 20³⁰ është pak dhe kjo do të ishte e mirë për qytetarët.

Majlinda Sylejmani, ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Rregullore dhe e dijmë që me këtë Rregullore do të rregullohen çështjet e transportit për udhëtarët ku do të kemi shtim edhe të disa linjave të reja që është kërkesë e banorëve. Shpresoj që kjo Rregullore do t'i përmbush obligimet e kompanive transportuese. Po ashtu shpresojmë që edhe inspektoriat të marrë masat për pa rregullësit që bëhen.

Fehmi Rexhepi, na e përkrahim këtë Rregullore por e kemi një kërkesë për fshatin Medvec dhe Magurë-Vrellë për me pasur një autobus me i lehtësu nevojat e udhëtimit për këto fshatra.

Afrim Miftari, ne edhe në KPF, kemi kërku që në qytet aty ku janë kabinat të vendoset një orar për linjat e udhëtarëve. Kërkesë e jona në KPF ka qenë që stacioni që është te Bestini të bëhet përpjekje të qohet më lart ose më poshtë pasi që po krijohet tollovi. Ne e përkrahim këtë projekt Rregullore të tillë.

Lulzim Rustemi, është një Rregullore që ka me ngritë çështjen e udhëtimit, e udhëtarëve të komunës së Lipjanit. Këtu po shihen 26 linja nuk e di a i takon linja Lipjan-Prishtinë. Në mbrëmje ka një qarkullim shumë të madh të udhëtarëve në lijen Lipjan-Prishtinë dhe ka qarkullim deri në orët e vona të mbrëmjes. Janë 26 linja në Lipjan nuk e di se a i takon edhe linja Lipjan-Prishtinë. Duhet të shtohet edhe linja Lipjan-Prishtinë siqë e ceku edhe Ramizi. Është një kërkesë e qytetarëve në kohën kur nuk ka mësim nuk qarkullojnë autobusat në të njëjtin orar dhe kërkesë e qytetarëve është që të qarkullojnë autobusët edhe kur nuk ka nxënës. Në fund tha kam një pyetje për ato vende që ka pak udhëtar zakonisht organizohet udhëtimi me kombibus deshta me ditë a kanë të drejtë dhe a kanë leje.

Ilir Tasholli, vendosja e orareve të autobusëve nuk do të ishte vështir për neve që të vendosen në stacionet pritëse të autobusëve por kemi projektin e sinjalizimit në qytetin e Lipjanit. Sa i përket pyetjes për linja më të shpeshta për Teqe dhe Janjevë asnjë kompani nuk ka pasur të interesuar për këto lokacione. Ne kemi me i shpallë ato vija mirëpo çdo vit që shpallen nuk ka të interesuar për ato linja. Ndërsa sa i përket pyetjes që të ketë linja më të vona kompetente për këtë çështje është Ministria e transportit. E kemi mendu edhe çështjen e largimit të stacionit të Bestini por kemi analizu mirë dhe e kemi pa që nuk kemi vend më të përshtatshëm se aty.

Hyra Bytyçi, sa i përket relacionit Metdvec – Lipjan nëse nuk ka pasur të interesuar për ta marrë këtë linje si do ta menaxhoni këtë çështje a mund të bëni diçka që banorët e fshatit Medvec të kenë transport.

Ilir Tasholli, ne kemi me i shpall linjat edhe për Medvec shpresojmë që dikush kamë me marrë atë linjë.

Nehat Tërpeza, kam një sçarim për disa pyetje të disa kolegëve për linjat e autobusëve të cilat mund të shtohen mirëpo nuk ka të interesuar pasi që kompanit e autobusëve nuk kanë lëvërdi.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pikë nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 27 votat për, aprovoi këtë:

Shtesë: Rregullorja.

VI

Propozim vendim për miratimin e Planit për ri-organizimin e pikave të mbeturinave në qytetin e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Ilir Tashollit, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Egzona Bytyqi, ne si grup e kemi shqyrtu këtë propozim vendim e falenderojmë kompanin Gjermane për bashkëpunim. Kam një pyetje strategjia afatëgjate kur kamë me u përfshi edhe viset rurale që kanë për qëllim largimin e mbeturinave.

Shkelzen Bislimi, a janë funksional kontinjerët nëntokësorë në qytetin e Lipjanit.

Nazmi Krasniqi, në planifikimin afatëgjatë a keni parapa klasifikimin e mbeturinave në qytet.

Lulzim Rustemi, shpresoj që ky riorganizimi i ri të sjellë më pak telashe rreth mbeturinave, a keni paraparë nëpër qendra të mëdha siqë janë: Gadime, Janjeva, Magura, që ka nevojë për kontinjer të mdhenjë përndryshe rritja e numrit të kontinjerëve në fshatrat e komunës së Lipjanit është i domosdoshëm për ndryshe ne e përkrahim këtë propozim vendim.

Ilir Tasholli, kanë qenë ekspert e GIZIT dhe ekspert e tonë që kanë bërë një punë të mirë për dy javë dhe janë përfshi të gjitha vendet aty ku kemi pasur mundësi. Është një plan fillestar. Kontinjetët nëntokësor janë funksional.

Lulzim Rustemi, te rruga Skënderbeu përballë furrës Drini janë disa kontinjer të cilët po shkaktojnë tollovi.

Ilir Tasholli, ata kontinjer në atë pjesë kanë me u largu kanë me kalu në pjesën tjetër ka Kisha.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 vota për, aprovoi këtë:

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT PËR RI-ORGANIZIMIN E PIKAVE TË GRUMBULLIMIT TË
MBETURINAVE NË QYTETIN E LIPJANIT

Neni 1

MIRATOHET Plani për ri-organizimin e pikave të grumbullimit të mbeturinave në qytetin e Lipjanit.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani për ri-organizimin e pikave të grumbullimit të mbeturinave në qytetin e Lipjanit.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Inspeksion.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës .

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 14,⁴⁰

Ekstraktin e hartoi
Rrahim Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi